



VENDIM

Nr. 30 Datë 18.03.2013

**PËR
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “DUKA T2” SH.P.K NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “TUCEP 2”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 , gërma “a”; 9, dhe pika 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “ a ”, 5 pika 1, gërma “ a ” 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.03.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DUKA T2” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “DUKA T2” Sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik(neni 9,pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) eshte plotesuar ne menyre korrekte.)

- Dokumentacionit qe ka te beje me miratimin e pikes se lidhjes me sistemin e shperndarjes dhe marrja e lejes mjedisore jane ne process miratimi.(neni 9 pika 4.1.5,Leje nga institucione te tjera)

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “DUKA T2” Sh.p.k në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “TUCEP 2” me fuqi te instaluar 1,7 MW.
2. Shoqëria “DUKA T2” te paraqese ne ERE lejen e pikjes se lidhjes me rrjetin e shperndarjes brenda 60 diteve nga miratimi i saj.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI